

TIK 7

LIBËR MËSUESI

Përmbajtje

HYRJE

1. PROGRAMI DHE KOMPETENCAT KYÇE	3
1.1 REZULTATET KRYESORE TË TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE QË REALIZOHEN NËPËRMJET LËNDËS SË TIK-UT PËR SHKALLËN E TRETË (KLASA VI-VII).	6
1.2 KOMPETENCAT E FUSHËS	7
1.3 LIDHJA NDËRMJET KOMPETENCAVE KYÇE TË FUSHËS DHE TEMATIKAVE	10
1.4 LIDHJA E TIK-UT ME FUSHAT E TJERA	11
2. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS	12
2.1 PLANIFIKIMI VJETOR	13
2.2 PLANIFIKIMI 3-MUJOR	15
2.3 PLANIFIKIMI DITOR SIPAS TEMATIKAVE TË PROGRAMIT	23
3 VLERËSIMI	92

Hyrje

I dashur koleg!

Ne kemi menduar të lehtësojmë punën tuaj, duke vendosur informacionet më të detajuara rreth metodologjisë së mësimdhënies në procesin mësimor. Përveç kësaj jemi duke përgatitur modele fletësh vetëvlerësimi për nxënësit si dhe formate detyrash, për portofolin e nxënësit. Këto do t'i gjeni në faqen tonë www.botimepegi.al, duke filluar nga muaji shtator 2016 dhe do të jenë të aksesueshme nga çdo mësues/e.

Në kohët e sotme, TIK-u po zë gjithnjë e më shumë vend në zhvillimin e shpejtë të shoqërisë. Për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimeve të kohës, është i nevojshëm integrimi i TIK-ut në arsimin bazë, pasi ndikon në zhvillimin e kompetencës digjitale të të gjithë nxënësit. Fëmijët e sotëm fillojnë të përdorin mjetet digjitale në një moshë shumë të re, ndaj shkolla duhet t'u përgjigjet nevojave të nxënësit/es.

Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës. Në një botë ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit, të cilat mësuesi/ja duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

TIK-u dhe teknologjia *janë* një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ajo integron shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme. Për këtë arsye, kjo formë është e pranishme në shumë fusha të të nxënës, veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

Përse shërben ky libër?

Ky libër do t'iu shërbejë mësuesve të TIK-ut për zhvillimin interaktiv të orës së mësimi, si dhe do të synojë zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimi po zbaton mësimdhënien bazuar në **kompetenca**, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit e TIK-ut, të cilët do të ndërtojnë punën e tyre të përditshme duke u bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, si dhe programi mësimor*.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit që japin mësim në klasën e shtatë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së TIK-ut, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe të nxënësit e klasës së shtatë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, konform dokumenteve zyrtare dhe fazave nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së shtatë (shkalla tre) e lëndës së TIK-ut, miratuar nga MAS-i në dhjetor 2014.

Meqenëse jemi në hapat e parë të kësaj reforme me qasjen e re bazuar në kompetenca,

ky libër merr përsipër të:

- sqarojë çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatohet çdo mësues/e në lëndën e tij/saj.
- udhëzojë të gjitha formatet e reja: plani vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënësve, formatet e vlerësimit etj., me të cilat duhet të punohet mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ky libër ofron modele që sugjerojnë forma se si mësuesi/ja të zhvillojë orën mësimore. Ai/ajo është i/e lirë t'i ndryshojë sipas nevojave të nxënësve në klasën e tij/saj. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënësve, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

1. Programi dhe kompetencat kyçe

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, kompetenca kyçe të arsimit bazë janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
2. Kompetenca e të menduarit.
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.
5. Kompetenca personale.
6. Kompetenca qytetare.
7. Kompetenca digjitale.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë:

Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të fushës/lëndës**, si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet fushës së teknologjisë dhe TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi/ja të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi/

ja duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat (të cilat jepen në mënyrë të detajuar në libër). **Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës/e duhet t'i ftojë gjatë procesit të të nxënës.**

Kompetenca demonstron nga nxënësi/ja (njohuri), bazohet në performancën e tij/saj (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimi të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi/ja duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë përse e bën. Kur nxënësi/ja realizon kompetencat digjitale, ai/ajo njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

P.sh., kompetenca digjitale “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës së TIK-ut mësuesi/ja ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatet e të nxënës për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi/ja në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxënës për kompetencat kyçe për secilin vit mësimor rezultatet e të nxënës për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatet e të nxënës për shkallë për kompetencat e fushës/lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi/ja;
- zbërthen në rezultate të nxënës për kompetencat e fushës/lëndës së tik-ut për vit mësimor, rezultat-in/et e të nxënës për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënës të kompetencave digjitale një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënës për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënës brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecures së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënës për vit mësimor dhe për shkallë për fushën e teknologjisë dhe të TIK-ut.

Programi përmban 5 tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Bazuar në 5 tematikat e programit është hartuar libri i nxënës, si dhe ky libër mësuesi, që jep të organizuar hap pas hapi trajtimin e situatës mësimore sipas tematikave.

Në këtë libër mësuesi do të gjeni:

- Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe dhe kompetencës digjitale
- Planin mësimor vjetor të organizuar sipas tematikave

- Planin mësimor tremujor
- Tabelën e organizimit të orës mësimore për çdo temë mësimi

Libri është i shoqëruar me CD-në, në të cilën do të gjeni fletë pune dhe ushtrime që mund t'i realizoni në klasë me nxënësit, si dhe informacion për të trajtuar orën mësimore.

1.1 Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe, që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e tretë (klasa VI-VII).

Kompetenca digjitale

- Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin
- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Përdorimi digjital-i imazheve për të modifikuar ose krijuar vepra të artit për një prezantim digjital.
- Shpjegon avantazhet dhe disavantazhet në përdorimin e teknologjive të ndryshme për të afruar informacionin për dëgjues të synuar. (p.sh: krahasojnë komunikimin përmes videove dhe mjeteve të komunikimit masiv; e-mail, CD-messenger)
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
- Përcakton mjetet e duhura teknologjike për qasjen në informacione dhe burime elektronike.
- Zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është primar ose sekondar).
- Ndërton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit, si dhe të feedback-ut të marrë nga mësuesit ose nxënësit e tjerë.
- Debaton mbi ndikimin, avantazhet dhe dizavantazhet e teknologjive ekzistuese dhe të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive
- Veçon informacionin kryesor nga një lburim digjital (internet, radio, TV etj..) e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim.
- Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

Kompetenca e të menduarit	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi/ja: mendon në mënyrë krijuese; zgjidh një problem dhe arsyeton për zgjedhjen e procedurave përkatëse; përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.
Kompetenca e të nxënit	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi/ja: mëson për të nxënë; përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme digjitale (internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet; përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi/ja: kontribuon në mënyrë produktive; përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrime, disajne (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve).
Kompetenca personale	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi/ja: bën jetë të shëndetshme; identifikon shenjat/simbolet e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete.
Kompetenca qytetare	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi/ja: përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët; identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe jashtë saj dhe propozon masa konkrete për parandalimin e tyre duke përdorur mjetet digjitale; merr pjesë në rrjetet sociale që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Për të ndihmuar në organizimin e mësimi me bazë kompetencat, në paragrafin në vijim jepen kompetencat e lëndës së TIK-ut dhe shpjegimi i tyre.

Këto kompetenca duhet të jenë në fokus të organizimit të tematikës mësimore.

1.2 Kompetencat e fushës


- Kreativiteti dhe inovacioni
- Komunikimi dhe bashkëpunimi
- Kërkimi dhe gjetja e informacionit
- Mendimi kritik, problem-zgjidhës dhe vendimmarrja
- Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike

Tabela 1: Kompetencat e fushës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të fushës

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave
Kreativiteti dhe inovacioni	<ul style="list-style-type: none"> - Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë: përdor teknologjinë për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin në produktet që realizon gjatë proceseve të punës. - Zhvillimi i përmbajtjes: të krijojë përmbajtje në formate të ndryshme duke përfshirë multimedian, të rregullojë dhe të përmirësojë përmbajtjen që ai ose të tjerët kanë krijuar, të shprehë kreativitetin nëpërmjet mediave dhe teknologjive digjitale. - Integrimi dhe ripërpunimi: të modifikojë, të pastrojë dhe përpunojë burimet ekzistuese për të krijuar përmbajtje dhe njohuri të reja, origjinale dhe të përshtatshme. - E drejta e autorit dhe licencat: të kuptojë si e drejta e autorit dhe licencat zbatohen në informacionin dhe përmbajtjen. - Programimi: të aplikojë parametrat, modifikime programi, aplikime programi, <i>software</i>, pajisje, të kuptojë parimet e programimit, të kuptojë çfarë është pas një programi.
Komunikimi dhe bashkëpunimi	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëveprimi ndërmjet teknologjisë: të bashkëveprojë nëpërmjet llojeve të ndryshme pajisjesh dhe aplikacioneve digjitale, të kuptojë se si komunikimi digjital është shpërndarë, paraqitur dhe drejtuar, të kuptojë rrugët e përshtatshme të komunikimit nëpërmjet mjeteve digjitale, t'u referohet formateve të ndryshme të komunikimit, të përshtatë modelet dhe strategjitë e komunikimit për një audiencë specifike. - Shpërndarja e informacionit dhe e përmbajtjes: të ndajë me të tjerët vendndodhjen dhe përmbajtjen e informacionit të gjetur, të jetë i gatshëm dhe në gjendje për të ndarë njohuritë, përmbajtjen dhe të veprojë si ndërmjetës, të jetë aktiv në shpërndarjen e të rejave , përmbajtjeve dhe burimeve, të dijë rreth praktikave dhe të integrojë informacion të ri në trupin e njohurive ekzistuese. - Angazhimi i qytetarisë online: të marrë pjesë në shoqëri nëpërmjet angazhimeve online, të kërkojë mundësi për vetëzhvillimin dhe fuqizimin duke përdorur teknologjitë dhe mjediset digjitale, të jetë i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive për pjesëmarrjen e qytetarëve. - Bashkëpunimi ndërmjet kanaleve digjitale: të përdorë teknologjitë dhe median për punën në grup, të bashkëpunojë në proceset e bashkëndërtimit dhe bashkëkrijimit të burimeve, njohurive dhe përmbajtjes.


	<ul style="list-style-type: none"> - Etika e komunikimit online: të dijë dhe të njohë si janë rregullat e sjelljes online/ ndërveprimet virtuale, të jetë i vetëdijshëm për aspektet e diversitetit kulturor, të jetë i aftë të mbrojë veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme online, të zhvillojë strategjitë aktive për të zbuluar sjelljet e papranueshme. - Administrimi i identitetit digjital: të krijojë, adaptojë dhe drejtojë një ose më shumë identitete digjitale, të jetë i aftë të mbrojë reputacionin e dikujt, të merret me të dhënat që ai prodhon përmes disa llogarive të aplikimeve.
Kërkimi dhe gjetja e informacionit	<ul style="list-style-type: none"> - Shfletosja, kërkimi dhe filtrimi i informacionit: të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të artikulojë nevojat informative, të gjejë informacionin e përshtatshëm, të zgjedhë burimet efektive, të lundrojë ndërmjet burimeve online, të krijojë strategji personale informacioni. - Vlerësimi i informacionit: të mbledhë, të përpunojë, të kuptojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin. - Ruajtja dhe rigjetja e informacionit: të ndryshojë dhe të ruajë informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, të organizojë informacione dhe të dhëna.
Mendimi kritik, problem-zgjidhës dhe vendimarrja	<ul style="list-style-type: none"> - Zgjidhja e problemeve teknike: të gjejë problemet e mundshme dhe t'i zgjidhë ato (nga <i>trouble-shooting</i> në zgjidhjen e problemeve më komplekse) me ndihmën e mjeteve digjitale. - Gjetja e nevojave dhe përgjigjeve teknologjike: të vlerësojë nevojat e veta në termat e burimeve, mjeteve dhe zhvillimit të kompetencave, të përshtatë nevojat me zgjidhjen e mundur, të përshtatë mjetet me nevojat personale, të vlerësojë në mënyrë kritike zgjidhjet e mundshme dhe mjetet digjitale. - Gjetja e boshllëqeve të kompetencave digjitale: të kuptojë kur kompetencat e veta nevojiten të përmirësohen ose të përditësohen, të mbështesë të tjerët në zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale, të mbajë dhe të japë zhvillimet e reja.
Mbrojtja	<ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja e pajisjeve: të mbrojë pajisjet e veta dhe të kuptojë rreziqet online dhe kërcënimet, të marrë njohuri rreth mbrojtjes dhe masave të sigurisë. - Mbrojtja e të dhënave personale: të kuptojë termat e zakonshme të shërbimit, të aktivizojë mbrojtjen e të dhënave personale, të kuptojë privatësinë e njerëzve të tjerë, të mbrojë veten nga mashtrimet dhe kërcënimet në internet. - Mbrojtja e shëndetit: të shmangë, në të mirën e shëndetit fizik dhe psikologjik, rrezikun që lidhet me përdorimin e teknologjisë në termat e kërcënimeve. - Mbrojtja e mjedisit: të jetë i vetëdijshëm për ndikimin e TIK-ut në mjedis.

1.3 Lidhja ndërmjet kompetencave kyçe të fushës dhe tematikave



1.4 Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera

Planifikimi i kurrikulës



Korrigjimi në mënyrë automatike i gabimeve ortografike, vendosja e duhur e sintaksës. Gjatë dërgimit të *e-mail*-eve të shihet nëse është zgjedhur adresa e saktë dhe nëse është përdorur gjuha e duhur ndaj dërguesit. Kur nxënësit mësojnë ndarjen e paragrafëve dhe të fjalëve, atyre u korrigjohet edhe ana linguistike, si dhe shihet nëse ndarja e paragrafëve është e saktë. Nëpërmjet CD-ROM dhe DVD ata zhvillojnë më shumë fjalorin, duke e pasuruar atë dita-ditës. Ana vizuale i ndihmon nxënësit të mbajnë mend më shpejt dhe më lehtë shumë fjalë.

Të hedhurit e të dhënave matematikore, nxënësit mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijimi i një database ku të hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, ditëlindja, vendlindja etj. Kjo database mund të përdoret më pas për përlogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar excel-in.

Për të kuptuar më mirë eksperimentet, nxënësit ndjekin eksperimente, të cilat gjenden online, dhe shumë lehtë edhe në faqen e **www.youtube.com**, po edhe në faqe të specializuara për shkencat ekzakte. Nxënësit mund të organizojnë projekte kurrikulare, duke përdorur internetin për gjetje informacioni dhe PowerPoint-in për prezantim.

Nxënësit e përdorin internetin për të gjetur informacion në lidhje me fenomenet gjeografike dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre mbi faktet historike. Gjithashtu, nëpërmjet internetit ata njohin më nga afër qytetet, të cilat mund t'i vizitojnë në të ardhmen. Për të kuptuar më mirë hapësirat, pozitat gjeografike dhe zhvendosjen në terren, nxënësit përdorin **www.googlemap.com**.

Nxënësit i përdorin këto mjete për të përvetësuar më mirë lëndën e Muzikës. Duke i ndjekur imazhet vizualisht ose duke krijuar pjesë të vogla muzikore nëpërmjet përdorimit të teknologjive. Nëse nxënësit e dëgjojnë këngën, por në të njëjtën kohë kanë dhe mundësinë të shohin videoklipin e saj, kjo e bën më të lehtë mësimin e muzikës.

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Siguria në Internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter	Kërkimi në Web/Internet	Përpunimi digjital i të dhënave dhe i prezantimit (Komunikimi funksional)	Gjithsej orë
Klasa e shtatë	3 orë	8 orë	11 orë	3 orë	10 orë	35 orë

2.1 Planifikimi vjetor

PLANI VJETOR, KLASA VI
LËNDA: TIK

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS			
TEMATIKAT	SHTATOR – DHJETOR Orët = 12 orë Teori = 11 orë, Testim = 1 orë	JANAR – MARS Orët = 10 orë Teori = 8 orë, Punë praktike kur realizohen të gjitha temat e mësuar në tremujorin 1 dhe 2 = 1 orë Testim = 1 orë	PRILL-QERSHOR Orët = 13 orë Teori = 12 orë, Testim = 1 orë
BOTAE KOMPJUTERIT	1.1 Zgjidhja e problemeve gjatë punës në kompjuter 1.2 Hapja e njëkohshme e disa dritareve në desktop 1.3 Viruset kompjuterike dhe mënyrat e mbrojtjes		
PËRPUNIMI DIGJITAL I TEKSTIT DHE ANALIZA E TË DHËNAVE	2.1 Header dhe Footer 2.2 Kërkimi i fjalëve nëpërmjet <i>Research</i> 2.3 Përpunimi digjital i imazheve 2.4 Analiza e të dhënave dhe përdorimi i formulave në <i>Excel</i> 2.5 Krijimi i grafikut në <i>Excel</i> 2.6 Shikimi paraprak i dokumentit të printuar (<i>Print Preview</i>) 2.7 Printimi i dokumentit 2.8 Problemet gjatë printimit		

KËRKIMI NË INTERNET	Nxënësit fillojnë të realizojnë detyrat në lëndë të ndryshme duke kërkuar informacione në Internet.	3.1 Kërkimi në Internet 3.2 <i>E-mail</i> -i dhe shërbime të ngjashme 3.3 Shërbimet e ruajtjes dhe të veprimit mbi informacionet në <i>Web</i> 3.4 Metodat e kërkimit në <i>Web</i> 3.5 Kujdesi gjatë kërkimit në <i>Web</i> 3.6 Struktura e Internetit 3.7 Funksionimi i <i>Web</i> -it 3.8 Krijimi i faqeve <i>web</i>	
LUNDRO I SIGURT	Mësuesi/ja u kujton herë pas here nxënëseve kujdesin që duhet të tregojnë kur punojnë në kompjuter.	Mësuesi/ja rikujton njohuritë e përftuara në klasën e 6-të, për rregullat e kërkimit të sigurt kur lundrojnë në internet, kur hapin adresë <i>e-mail</i> -i ose kur përdorin rrjetet sociale.	4.1 Komunikimi dhe publikimi i informacioneve në Internet 4.2 Kujdesi gjatë publikimit në Internet 4.3 Siguria në Internet

PREZANTIMI DIGJITAL	Realizojnë punë të vogla nëpërmjet projekteve kurrikulare.	Nxënësit përdorin njohuritë e përfutuara në klasën e gjashtë për të realizuar punët praktike.	<p>5.1 Përfshirja e imazheve dhe e pjesëve muzikore në një prezantim</p> <p>5.2 Ruajtja e prezantimit</p> <p>5.3 Mënyrat e shfaqjes së slajdeve</p> <p>5.4 Përshtatja e prezantimit për printim</p> <p>5.5 Printimi i prezantimit</p> <p>5.6 Lidhja e laptopit me videoprojektorin</p> <p>5.7 Njohja me programin <i>Prezi</i></p> <p>5.8 Përpunimi i informacionit në <i>Prezi</i></p> <p>5.9 Realizimi i prezantimit në <i>Prezi</i></p> <p>5.10 Përsëritje e dy kapitujve</p>
	Testim	Testim	Testim

2.2 Planifikimi 3-mujor

PLANIFIKIMI 3-MUJOR (SHTATOR – DHJETOR)

FUSHA: Teknologji/TIK

LËNDA: TIK

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kryesore

- **Kompetenca dixhitale**
Nxënësi/jja:
 - *përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin;*
 - *përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimin në distancë për zhvillimin e njohurive;*
 - *shpjegon përparësitë dhe mangësitë në përdorimin e teknologjisë për të afëruar informacionin për dëgjues të synuar (p.sh. krahasojnë komunikimin përmes videove dhe mjeteve të komunikimit masiv: e-mail, CD, Messenger).*
- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**
Nxënësi/jja:
 - *përdor programe softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).*
- **Kompetenca e të menduarit dhe e të nxënësve**
Nxënësi/jja:
 - *zgjedh metodat për të emërtuar kompjuterat që janë në përdorim dhe bën krahasimin midis tyre;*
 - *përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.*
- **Kompetenca personale**
Nxënësi/jja identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete.

Tematikat	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Burimet
1. Bota e kompjuterit	1.1 Zgjidhja e problemeve gjatë punës në kompjuter 1.2 Hapja e njëkohshme e disa dritareve në desktop 1.3 Viruset kompjuterike dhe mënyrat e mbrojtjes	Nxënësit punojnë në laboratorin e Informatikës. Secili prej tyre gjendet përballë një situatë, si p.sh: monitori bëhet i bardhë ose i zi; nuk arrin të mbyllë një program; nuk dëgjon asnjë tingull nga altoparlanti etj. Kërkojuni më pas që ata të diskutojnë me njëritjetrit, duke zhvilluar kështu njohuritë e reja për t'u dhënë zgjidhje këtyre situatave.	<ul style="list-style-type: none"> Metoda interaktive / ndërvepruese/gjithëpërfshirëse Diskutim/rrijti i diskutimit/lojë Rrijti i diskutimit/punë e drejtuar 	<ul style="list-style-type: none"> Libri i nxënësit Libri i mësuesit Enciklopedi CD-ja e nxënësit <p>Mund të shihen edhe burime të tjera, të cilat do të përdoren nga mësuesi/ja për ta bërë më interaktive orën e mësimit.</p>
2. Përpunimi digital i tekstit dhe analiza e të dhënave	Përpunimi digital i tekstit: 2.1 <i>Header</i> dhe <i>Footer</i> 2.2 Kërkimi i fjalëve nëpërmjet <i>Research</i> 2.3 Përpunimi digital i imazheve 2.4 Analiza e të dhënave dhe përdorimi i formulave në <i>Excel</i>		<ul style="list-style-type: none"> Tabela e konceptit/veprimtari e drejtuar/provo veten <i>Brainstorm</i> Bashkëbisedim dhe ilustrim Rrijti i diskutimit/vëzhgo-analizo-diskuto/praktikë e pavarur 	

	2.5 Krijimi i grafikut në <i>Excel</i> 2.6 Shikimi paraprak i dokumentit të printuar (<i>Print Preview</i>) 2.7 Printimi i dokumentit 2.8 Problemet gjatë printimit			
--	--	--	--	--

Shënim : Orën e fundit, mësuesi/ja e shfrytëzon për të bërë testimin e tremujorit të parë.

PLANIFIKIMI 3-MUJOR (JANAR – MARS)

FUSHA: Teknologji/TIK

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurisë**
Nxënësi/ja:
- përdor programe softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).
- **Kompetenca e të menduarit dhe të nxënës**
Nxënësi/ja:
- përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes;
- përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi shoqëror duke paraqitur rezultat të njëjtë.
- **Kompetenca personale dhe qytetare**
Nxënësi/ja:
- identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete, paragjykimet që ekzistojnë në shkollë e jashtë saj dhe propozon masa konkrete për parandalimin e tyre duke përdorur mjetet dixhitale.

Tematikat	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Burimet
3. Kërkimi në internet	3.1 Kërkimi në Internet 3.2 E-mail-i dhe shërbime të ngjashme 3.3 Shërbimet e ruajtjes dhe të veprimit mbi informacionet në Web	1. Krijohen hapësira, ku nxënësi/ja kërkon informacion për një temë të caktuar, si p.sh: “Dita e Tokës”. 2. I kërkohet secilit nxënësi/e të hartojë një paragraf me informacionet që ai/ajo ka rreth shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> • Metoda interaktive / ndërvepruese/ gjithëpërfshirëse • Diskutim/rrjeti I diskutimit/lojë • Rrjeti I diskutimit/punë e drejtuar • Mapmapping • Teknika të vetëvlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Teksti i Nxënësit • Libri i mësuës • Enciklopedi • CD-ja e nxënësit <p>Mund të shrohet çdo burim që mund të përdoret mësuësi/ ja për ta bërë më interaktive orën e mësim.</p>

	<p>3.4 Metodat e kërkimit në <i>Web</i></p> <p>3.5 Kujdesi gjatë kërkimit në <i>Web</i></p> <p>3.6 Struktura e Internetit</p> <p>3.7 Funksionimi i <i>Web</i>-it</p> <p>3.8 Krijimi i faqeve <i>web</i></p> <p>1 orë punë praktike ose përsëritje kapitulli</p> <p>1 orë testim</p>	<p>3. të <i>e-mail</i>-it. Nxënësve u kërkohet gjithashtu të punojnë në çift, ku i tregojnë informacionet njëri-tjetrit.</p> <p>4. Secilit/ës nxënës/e i kërkohet të shpjegojë në tabelë mënyrat sesi i ruan informacionet.</p> <p>5. Më tepër informacion për situatat mësimore do të gjeni në plan-ditarët në vijim.</p>		
--	---	--	--	--

Shënim: Orën e fundit, mësuesi/ja e shfrytëzon për të bërë testimin e tremujorit të dytë.

PLANIFIKIMI 3-MUJOR (PRILL – QERSHOR)

FUSHA: Teknologji/TIK

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

- **Kompetenca dixhitale**
Nxënësi/jja:
- *Shpjegon përparësitë dhe mangësitë në përdorimin e teknologjive të ndryshme për të ofruar informacionin;*
- *krahason komunikimin përmes videoeve dhe mjeteve të komunikimit masiv: e-mail, CD, Messenger;*
- *ndërtton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit e të feedback-ut të marrë nga mësuesit ose nxënës të tjerë*
- *diskuton mbi ndikimin e teknologjive ekzistuese dhe atyre të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.*

Kompetenca qytetare

Nxënësi/jja:

- *merr pjesë në rrjetet sociale që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj. në shkollë apo në komunitet, ku përfaqësohen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësi e më gjerë.*

Tematikat	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Burimet
LUNDRO I SIGURT	4.1 Komunikimi dhe publikimi i informacioneve në Internet 4.2 Kujdesi gjatë publikimit në Internet 4.3 Siguria në Internet	1. Nxënësve u kërkohet të vendosen në grupe 4-she. Secili/a prej tyre përshkruan në fletë një moment, ku ai/ajo është ndier vërtet keq nga ajo që ka lexuar apo që mund të ketë publikuar në Internet. Secili prej nxënësve i ngjith këto fletë në tabelën e zezë.	<ul style="list-style-type: none"> • Bisedë/veprimtari e drejtuar/praktikë e pavarur. • Rikujtim i njohurive të marra/pyetje dhe punë në grupe. • Tabelë konceptesh rreth Internetit/demonstrim, punë e pavarur. • Veprimtari praktike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Informacione nga interneti. • Libri i nxënësit • Libri i mësuesit • Enciklopedi • CD-ja e nxënësit




		E rëndësishme është që nëpërmjet kësaj situatë të sqarohen konceptet e temës “Publikimi i informacioneve në Internet”.		
PREZANTIMI DIGITAL	1.1 Përfshirja e imazheve dhe e pjesëve muzikore në një prezantim 1.2 Ruajtja e prezantimit 1.3 Mënyrat e shfaqjes së slajdeve 1.4 Përshtatja e prezantimit për printim 1.5 Printimi i prezantimit 1.6 Lidhja e laptopit me videoprojektorin 1.7 Njohja me programin <i>Prezi</i> 1.8 Përpunimi i informacionit në <i>Prezi</i> 1.9 Realizimi i prezantimit në <i>Prezi</i> 1.10 Përsëritje e dy kapitujve			
	Testim			

Shënim : Orën e fundit, mësuesi/ja e shfrytëzon për të bërë testimin e tremujorit të tretë.

Planifikimi ditor sipas tematikave të programit



Mësimi 1.1

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 1. Bota e kompjuterit Tema mësimore: Zgjidhja e problemeve gjatë punës në kompjuter Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>Përshkruan problemet që mund t'i lindin gjatë punës në kompjuter, në nivelin hardware ose software.</i>		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Mund t'ju ndodhë që gjatë punës në kompjuter të gjendeni përpara situatave të ndryshme, si p.sh.: monitori bëhet i bardhë ose i zi, nuk arrini të mbyllni një program, nuk dëgjoni asnjë tingull ose zë nga altoparlanti etj. Si mendoni, si mund t'u jepni zgjidhje këtyre situatave?</i> Situata e të nxënit (veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje rreth çështjes që u hodh për diskutim, duke përdorur njohuritë që kanë marrë për identifikimin e problemeve që mund të kenë hasur gjatë punës në kompjuter. Mësuesi/ja u tregon nxënësve në laborator pjesët e kompjuterit, të cilat pas shpjegimit ua lë atyre për t'i montuar. Nxënësve u ofrohet edhe trajnim për seanca aktivitete, ku do të ketë prezantim.	
		Hapi I – Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë mbi problemet që ndodhin në sistemin hardware , ato në software , <i>si</i> dhe problemet në sistemin operativ . Vendosen në tabelë fotografitë si më poshtë:	
		<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start;"> <div style="text-align: center;"> 1  </div> <div style="text-align: center;"> 2  </div> </div> <div style="text-align: center; margin-top: 20px;"> 3  </div>	

	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit (nëse diçka nuk shkon me sistemin <i>hardware</i> apo me atë <i>software</i>). Lexohet materiali në libër dhe më pas plotësohet pjesa tjetër e tabelës. Një nxënës/e shkruan në tabelë cilësitë e secilit kompjuter. Nxënësit e tjerë emërtojnë secilin nga sistemet duke i shkruar në fisha me ngjyra, të cilat më pas i ngjitin në tabelë. Nxënësit përshkruajnë secilin nga sistemet: software, hardware dhe operative, duke përdorur njohuritë e përvetësuara.</p> <p>Hapi III : Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i manualeve të shërbimit, të cilat mund të jenë në formë broshurash, <i>CD-ROM</i>-esh, <i>website</i>-sh.</p> <p>Nëse edhe pas hapave që jepen në libër, problemi nuk zgjidhet, atëherë nxënësve u shpjegohet nga mësuesi/ja që në raste të tilla të kërkohet ndihma e një specialisti.</p> <p>Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Lexohen me vëmendje hapat që duhet të ndiqen për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë punës në kompjuter.</p> <p>Ndahet klasa në dy grupe.</p> <p>Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna. Nëse njëri nuk përgjigjet saktë mbi pyetjen, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p> <p>-Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre me fjalë ose me vizatime.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti (enciklopedi, video, <i>CD-ROM</i>, <i>WEB</i>).</p> <p>Koncepte kyçe: <i>hard disk, CD ROM, RAM, motherboard (skeda mëmë), monitor, printer, tastierë, maus, hardware, software, sistemi operativ.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi.</p> <p>Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.



Vlerësimi:

Situata quhet e realizuar kur nxënësi/ja mund t'u përgjigjet pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e identifikimit të problemeve të kompjuterit në nivelet *hardware*, *software* dhe në sistemet operative.

Disa lloje vlerësimi që mund të përdoren nga mësuesi/ja

- Vlerësimi formues
- Vlerësimi nëpërmjet portofolit
- Vetëvlerësimi



Detyrat dhe puna e pavarur

Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.



Detyrë shtëpie: ndahet klasa në dy grupe, ku grupi I sjell material për: **Problemi 1:**

Kompjuteri nuk ndizet. Grupi II sjell materiale për: **Problemi 2:** Mause ose tastiera nuk funksionon.



Mësimi 1.2

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tematika 1. Bota e kompjuterit Tema mësimore: Hapja e njëkohshme e disa dritareve në desktop Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi\ja kryen hapjen e dy ose më shumë dritareve në desktop dhe punon njëkohësisht me to.</p>		<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi\ja hedh për diskutim situatën e mëposhtme: <i>Shpeshherë, gjatë punës në kompjuter ju lind nevoja të hapni më shumë se një dritare në desktop. Si veproni në raste të tilla? Kërkoni ndihmën e një të rrituri apo e përpigjeni vetë për ta mësuar?</i> Nxënësit japin përgjigjet e tyre lidhur me situatën e ngritur për diskutim nga mësuesi/ja, duke përdorur njohuritë që kanë marrë në klasën e gjashtë.</p> <p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesja shpjegon në laborator rreth temës së mësimi, duke nxitur herë pas here nxënësit të japin mendimet e tyre pas çdo hapi që ndiqet, duke e bërë orën interaktive.</p> <p>Hapi I – Rrjeti i diskutimit</p> <p>1-Diskutohet situata e dhënë në libër</p> <p>Sistemi operativ <i>Windows</i> çdo informacion e shfaq në monitor nëpërmjet disa kornizave, të cilat quhen dritare. Dritaret ndahen në dy grupe: dritare dialoguese dhe dritare programi.</p> <p>Tregohet me anë të videoprojektorit paraqitja e dritares dialoguese Computer me elementet e saj.</p> <p>Më pas shpjegohet se si kryhet hapja e tri dritareve në të njëjtën kohë: Computer, Microsoft PowerPoint, Microsoft Excel.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Nxënësit japin përgjigje për pyetjet e mëposhtme, duke u bazuar në njohuritë e përvetësuara më parë.</p> <p>1. Ku ndryshojnë dritaret dialoguese nga dritaret e programit? 2. Cilat janë elementet kryesore të një dritareje? - Ndahet klasa në dy grupe.</p>	

	<p>Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre me fjalë ose me vizatime.</p>
<p>Burimet Teksti mësimor, laboratori i Informatikës, videoprojektor, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti. (enciklopedi, video, CD-ROM, WEB), Koncepte kyçe : sistemi operativ <i>Windows</i>, <i>dritare dialoguese</i>, <i>dritare programi</i>.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete, për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e punimit të njëkohshëm në disa faqe. Disa lloje vlerësimi që mund të përdoren nga mësuesit</p> <ol style="list-style-type: none"> Vlerësimi formues Vlerësimi nëpërmjet portofolit Vetëvlerësimi 	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër. Detyrë shtëpie: ndahet klasa në dy grupe, ku grupi I sjell informacione dhe foto për dritaret dialoguese, ndërsa grupi II sjell informacione dhe foto për dritaret e programit.</p>	

Shënim: Këto figura, mësuesi mund t'i printojë të zmadhuara dhe t'i përdorë gjatë orës së mësimi.





CRT



LCD



Printer




Plotter



Speaker


2. Ç'ka paraqet procesori (CPU)?

- Është një pajisje e brendshme kompjuterike dhe është pjesa kryesore lu bëhet përpunimi i informatave hyrëse-dalëse dhe ai përcakton kompjuterin se me çfarë kompjuteri kemi të bëjmë, kemi disa lloje procesorësh si p.sh. AMD, Pentium etj.
- Në kontrollin e punës së kompjuterit, procesori është përgjegjës për dy detyra: merr intruksionet e programeve nga memoria dhe i ekzekuton këto instruksione!



Mësimi 1.3

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 1. Bota e kompjuterit Tema mësimore: Viruset kompjuterike dhe mënyrat e mbrojtjes Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>- përshkruan problemet që mund t'i lindin gjatë punës në kompjuter, në nivelin hardware ose software;</i> <i>- ç'instalon programet nga skedari i software-it dhe shkarkon një program më te përditësuar.</i>		Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi\ja hedh për diskutim si më poshtë: Kompjuterat mund të marrin viruse. Cilat janë mënyrat më të njohura të përhapjes së viruseve? A ju ka ndodhur të keni pasur në kompjuterin tuaj virus? Cilat janë dëmet që shkaktojnë viruset? Pyetjen e fundit mësuesi/ja e shkruan në tabelë. Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Nxënësit diskutojnë dhe i japin përgjigje pyetjes duke përdorur njohuritë që ata mund të kenë. Gjatë diskutimit është e rëndësishme të dalë në pah se cilat janë format që ne ruajmë kompjuterin kur punojmë. Hapi I –Rrjeti i diskutimit 1-Diskutohet situata e dhënë në libër. -Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë. Diskutohet rreth problemeve që ndodhin në sistemin hardware apo në sistemin software , si dhe problemeve në sistemin operativ (mësimet 1.1 & 1.2). Më pas kalohet në mësimin e ri, i cili flet për viruset që infektojnë kompjuter.	



	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Lexohet materiali në libër dhe më pas diskutohet rreth problemeve që mund të ndodhin gjatë infektimit të kompjuterit nga viruset. Nxënësi do të komentojnë mënyrat e shfaqjes së viruseve, si dhe mënyrat e instalimit dhe çinstalimit të antivirusëve.</p> <p>- Nxënësi/ja përshkruan secilën nga mënyrat e përdorimit të antivirusëve që mund të përdoren në kompjuter duke përdorur njohuritë që dinë.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Më pas diskutohet dhe tregohen hapat për zgjidhjen e problemeve. Ndahet klasa në grupe (punë në dyshe). Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten</p> <p>Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1 Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2 Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nxënës nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit. Nxënësi argumentojnë përgjigjet e tyre me fjalë ose me vizatime.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, teksti mësimor, enciklopedi, video, CD-ROM, WEB.</p> <p>Koncepte kyçe: hard disk, <i>CD ROM</i>, <i>RAM</i>, <i>motherboard (skeda mëmë)</i>, monitor, printer, tastierë, maus, sistemin hardware, ato në <i>software</i>, si dhe problemet në <i>sistemin operativ</i>.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p> <p>Virusi është një program i vogël, i cili është në gjendje të shumëzohet e të shpërndalet nëpër funksionet e caktuara të kompjuterit dhe ta bëjë atë që të mos funksionojë normalisht apo ta shkatërrojë gjithë sistemin e eksplorimit.</p> <p>Por dëmet mund të jenë të ndryshme: disa lloje virusesh sjellin pak dëme, p.sh., ata që sulmojnë mausin apo tastierën, disa të tjerë pengojnë disa programe të funksionojnë normalisht, por më të rrezikshmit sot janë në gjendje ta fshijnë tërë hard diskun.</p>	

Vlerësimi

Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e vendosjes së antivirusëve në kompjuter .

Disa lloje vlerësimi që mund të përdoren nga mësuesit:

- Vlerësimi formues
- Vlerësimi nëpërmjet portofolit
- Vetëvlerësimi

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në fund të orës, nxënësit zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.

Detyrë shtëpie: Ndahet klasa në katër grupe

Grupi I sjell material dhe foto për mënyrat e përhapjes së viruseve.

Grupi II sjell materiale dhe foto për dëmet që shkakton një virus kompjuterik.

Grupi III sjell materiale dhe foto për shenjat që mund të tregojnë që një kompjuter mund të jetë i infektuar.

Grupi IV sjell materiale dhe foto për instalimin dhe përditësimin e antivirusëve.

Shënim: Figurat e mëposhtme, mësuesi/ja mund t'i printojë të zmadhuara dhe t'i përdorë gjatë orës së mësimit, ku mund të përzgjidhen dhe foto të tjera.



CFARE JANE VIRUSET ?



- Viruset janë programe të ndërtuara mbi kod dhe/ose skripte, që ndryshojnë nga programet e tjera në kompjuter, ndërtohen në shumicën e rasteve me qëllime dashakeqe. Të më shumicën e rasteve, sepse në raste të rralla ka edhe viruse që krijojnë me qëllim mbrojtjeje, siç është NATO, FBI apo organizata të tjera. Disa viruse infektjnë skedarët .com apo .exe, ndërsa disa të tjera përhapen duke i'u bashkangjitur përshembull dokumenteve Word apo Excel. Kur një skedar i infektuar aktivizohet nga përdoruesi, (sipas llojit), aktivizohet në format e tij të ndryshme edhe vetë virusi. Viruset kanë një "payload". Me fjalën "payload" nënkuptohet qëllimi final për të cilin është ndërtuar ai virus.

VIRUSET DHE ANTIVIRUSET



➤ Si të mbrohem prej virusëve?

Mbrojtja më e mirë është që t'i parandalosh dhe mos t'u japësh mundësi të infektujë skedarët e kompjuterit, prandaj nevojiten programe antivirus që janë të aftë të zbulojnë viruset dhe të mbrojnë kundër infektimit.



➤ Si punojnë antiviruset?

Detyra e programit të njohur si antivirus është që të monitorojnë punën e

Kompjuterit dhe të mbrojnë kompjuterin nga viruset mundshme

kompjuterike. Antiviruset kanë një listë të madhe të viruseve të njohur dhe monitorojnë

kompjuterin gjatë gjithë kohës për të zbuluar nëse ndonjë prej tyre është futur në kompjuter.

Disa antiviruset azhurnohen automatikisht, ndërsa disa

të tjerë duhet të azhurnohen nga përdoruesi i kompjuterit, zakonisht duke shkarkuar

dhe instaluar azhurnimet nga faqja e kompanisë në internet.



➤ Si hyjnë në kompjuter?

Viruset shpërndahen me të gjitha mënyrat që shpërndahen edhe skedarët e tjerë. Ata mund të shkarkohen nga interneti, mund të bashkëngjitur në email, mund të hyjnë nga kompjuterët e tjerë, nga disketat, CD, etj. Disa viruse përhapen vetvetiu duke shfrytëzuar dobësi të sistemit operativ (Windows, Linux, Mac, etj.), por shumica e tyre merren në kompjuter nga vetë përdoruesi. Pra rruga më e shpejtë e përhapjes së viruseve kompjuterik është ajo e internetit.





- - Viruset ActiveX dhe Java : Keta jane viruse qe mund te shfrytezojne kontrollet e ndryshme qe mund ti jene shtuar nje faqeje web. (Gigger...)





Mësimi 2.1

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Header dhe Footer Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: - Shton një informacion nëpërmjet rubrikave <i>Header</i> dhe <i>Footer</i> në një dokument të shkruar; - kupton rëndësinë e përdorimit të <i>Header</i> -it dhe të <i>Footer</i> -it në dokumente të rëndësishme; - ndryshon opsionet (të dhënat bazë) të grafikëve.		Situata e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për realizimin e kësaj teme, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë ... <i>Si mund ta kemi më të lehtë për të identifikuar një dokument që të jetë më i dallueshëm në rubrikat Header dhe Footer?</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë për faqen e punës kur ata punojnë në <i>Word</i> . Diskutohet bashkë me mësuesin/en edhe situata e paraqitur në libër nëpërmjet rubrikës “ Aktivitet ”. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë që kanë marrë më parë lidhur me problemet që hasin në vendosjen e elementeve të duhura (titulli, nr. i faqes etj.) në tekstin e një dokumenti zyrtar ose të një detyre të caktuar në kompjuter. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Nëpërmjet videoprojektorit, mësuesi/ja shpjegon hapat që ndiqen për të punuar mbi një tekst duke i shtuar atij elemente të domosdoshme për t’u identifikuar dhe për t’u përdorur për një qëllim të caktuar. Në fillim duhet të evidentojmë se çfarë lloj teksti është, emrin e autorit, datën dhe vendin ku është shkruar. Më pas diskutohet rreth situatës në rubrikën “ Aktivitet ”.	

	<p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Nxënësit kontrollojnë njohuritë e përvetësuara gjatë orës së mësimit, duke i bërë pyetje njëri-tjetrit për disa minuta.</p> <p>Hapi IV Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit për një përgjigje më të qartë dhe të plotë.</p>
<p>Burimet</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office, Microsoft Word</i>.</p> <p>Koncepte kyçe: <i>Header, Footer.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimit, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e shkrimit të letrave zyrtare.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Ndahet klasa në dy grupe.</i> <i>Grupit I i caktohet të shkruajë një dokument zyrtar, drejtuar një institucioni ose drejtuesi institucioni.</i> _____ <i>Grupit II i caktohet të paraqesë me anë të një grafiku mungesat e nxënësve të klasës gjatë dy muajve të fundit.</i></p>	



Mësimi 2.2

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Kërkimi i fjalëve nëpërmjet Research Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: Përdor ikonën <i>Clip Art</i> për t'u përshtatur imazhe fjalëve të ndryshme Zbulon një gamë të gjerë fjalësh nëpërmjet ikonës <i>Research</i> në <i>Word</i>.		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim situatën si më poshtë: Si mendoni, si mund t'i gjejmë kuptimet apo sinonimet e fjalëve të ndryshme në Internet? Shpjegohet se nëpërmjet paketës <i>Microsoft Office</i> në <i>Word</i> mundësohen faqe kërkimi në gjuhë të ndryshme. Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Pasi hidhet për diskutim tema e mësipërme, nëpërmjet videoprojektorit hapet <i>Microsoft Word</i> dhe shkruhen komandat që duhen për të planifikuar gjetjen e fjalëve nëpërmjet fjalorëve, referencave etj. Më pas provojmë për të gjetur kuptimin ose sinonimin e një fjale për të cilën jemi të interesuar. Rikujtojmë gjithashtu se sistemi <i>Microsoft Office</i> ofron faqe kërkimi në të gjitha gjuhët që ka në dispozicion. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë. Si veprohet për të instaluar një gjuhë të re në kompjuter? Tregohet me anë të videoprojektorit mënyra nëpërmjet komandave, duke i plotësuar rubrikat përkatëse dhe në fund merret rezultati i kërkuar. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Përdorimi i <i>Clip Art</i>-it Mësuesi/ja hedh për diskutim çështjen se si mund të krijojmë një fletëpalosje, ku përveç informacionit të kemi edhe përmbajtje në formën e tekstit si dhe imazhe fotografike, pra duke filluar nga skica më e thjeshtë deri në një imazh fotografik.	

	<p>Demonstrohet në klasë me videoprojektor, si dhe ndjekim hapat njëri pas tjetrit për të realizuar një detyrë të bukur duke përdorur komandat e duhura.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive të marra Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja ndjek ecurinë e punës së tyre, duke i ndihmuar për pikat ku hasin vështirësi. Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit. Ora zhvillohet në kabinetin e Informatikës.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa Office, Microsoft Word, teksti mësues.</p> <p>Koncepte kyçe: Clip Art ,Microsoft Office.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e përdorimit dhe konkretizimit të punës së kërkuar.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 në faqen 17 në libër, jep udhëzimet përkatëse për realizimin e detyrës.</i></p>	



Mësimi 2.3

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Përpunimi digjital i imazheve Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - njeh formatet BMP dhe JPEG; - përpunon fotografitë: u ndryshon ngjyrat, pozicionin dhe i ruan në një dosje në formatin e dëshiruar. 		Situata e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë: <i>Në klasën e 6-të kemi mësuar që dokumentet mund t'i ruajmë në formate të ndryshme. Diskutojmë rreth tyre...</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit gjatë diskutimit rreth situatës së mësipërme japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë më parë. Çdo skedar ka emrin dhe prapashtesën përkatës. Kjo ilustron me shembuj nga mësuesi/ja, të tillë si: Ms Word -doc Ms Excel -exc etj. Tregohen me anë të videoprojektorit foto të ndryshme për t'u përpunuar edhe nga nxënësit. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Shpjegohen dy prej tyre, në fillim për formatet e imazheve në <i>Web</i> . Lexohet materiali në libër që flet rreth JPEG si dhe BMP. Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurie Hapi III: Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Tregohen hapat për zgjidhjen e problemeve për të bërë përpunimin e fotografive, duke renditur komandat përkatëse që jepen për shtimin dhe përpunimin e fotografive: zvogëlim, rrotullim me 90 °, ndryshim ngjyrash, prerje etj.	

	<p>Ndahet klasa në dy grupe.</p> <p>Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Grupet plotësojnë në libër ose në një fletë A4 ushtrimin 1 në libër.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre me fjalë ose me punë konkrete.</p>
<p>Burimet:</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve.</p> <p>Koncepte kyçe: JPEG, BMP.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi.</p> <p>Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e përpunimit digjital të imazheve.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i></p> <p><i>Detyrë shtëpie: ushtrimi 2 në faqen 20 të librit jep udhëzimet përkatëse.</i></p>	



Mësimi 2.4

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Analiza e të dhënave dhe përdorimi i formulave në Excel Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: - lexon gabimet që mund të dalin gjatë llogaritjes së qelizave në Excel; - përllogarit përmbajtjen e një qelize me anën e formulave.		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Rikujtojmë së bashku se çfarë kemi mësuar për llogaritjen e një qelize duke kryer veprime të thjeshta, si mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim.</i> <i>Si do të veprojmë për formula më të komplikuar kur të na duhet të kryejmë llogaritje?</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Gjatë diskutimit mbi temën e mësipërme, nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë për faqen e punës kur ata punojnë në Excel. Nga mësuesi/ja demonstron me anë të videoprojektorit në laboratorin e Informatikës llogaritja e formulës në një qelizë të dhënë, ku porositen nxënësit të tregojnë kujdes kur kryejnë veprimet në Excel. Duhet të theksohet që veprimet kryhen sipas radhës, ashtu si në Matematikë: <ol style="list-style-type: none"> 1. në fillim kryhen veprimet brenda kllapave; 2. pastaj shumëzimi ose pjesëtimi; 3. në fund mbledhja ose zbritja. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit - Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë mbi problemet që hasen në llogaritjet e një qelize të dhënë. Po kështu diskutohet për kopjimin e formulës dhe gabimet në Excel. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Lexohet materiali në libër, i cili flet për gabimet gjatë llogaritjes së një formule në Excel. Nga mësuesi/ja shpjegohet se te shiriti i menyve dhe komandave në Excel ndodhet menyja <i>Formulas</i> , e cila është	

	<p>specifike vetëm për këtë program, ku mund të krijojmë formula dhe funksione për llogaritjen e të dhënave, si dhe të bëjmë korrigjimet e mundshme. Po kështu, mund të shohim edhe shfaqjen e mesazheve të gabimit dhe shkaqet e mundshme.</p> <p>Mësuesi/ja paraqet dy shembuj, ku tregon për llogaritjen e shumave në qeliza.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur</p> <p>Kontrolli i njohurive duke përdorur Microsoft Excel .</p> <p>Hapi III:</p> <p>Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja tregon hapat për zgjidhjen e problemeve.</p> <p>Ndahet klasa në tri grupe.</p> <p>Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten</p> <p>Provo veten</p> <p>Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1.</p> <p>Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.</p> <p>Grupi III plotëson në dyshe pyetjen 3.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p> <p>-Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre duke sjellë edhe shembuj përkatës.</p>
<p>Burimet:</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office, Microsoft Excel</i>.</p> <p>Koncepte kyçe: Microsoft Excel 2007, Formulas, Formula Auditing etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi, teksti i Matematikës. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e identifikimit të problemeve të përdorimit të formulave në <i>Excel</i>.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i></p> <p><i>Detyrë shtëpie: Llogaritni me një formulë të thjeshtë mesataren e notave të dëftesës së vitit të kaluar.</i></p>	



Mësimi 2.5

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Krijimi i grafikut në Excel Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: Krijon një grafik duke marrë parasysh të dhënat e një tabele. Formaton dhe ndryshon të dhënat e një diagrami, p.sh.: titullin e tabelës, emrat e akseve kryesore. Zgjedh llojin e grafikut të duhur që ofron Excel-i për të prezantuar tabelën. (Radar, Surface, Doughnut, Bubble, Scatter, Line etj)		Situata e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Përveçse mund të ndërtojmë një grafik në Word, mund të krijojmë grafikë edhe në Excel. Si mendoni, a mund të jetë e vështirë kjo?</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje rreth situatës së mësipërme duke u bazuar në njohuritë që kanë për faqen e punës kur ata punojnë në Excel. Nga mësuesi/ja demonstrohen me anë të videoprojektorit në laboratorin e Informatikës hapat kryesorë që ndiqen për llogaritjen e formulës në Excel. Hidhet për diskutim në klasë edhe rubrika në libër “Aktivitet”. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigje duke u bazuar në njohuritë që kanë marrë më parë. Nga mësuesja demonstron mënyra për të shtuar një grafik në Ms Excel, duke ndjekur hapat përkatës. Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Dike ndjekur tabelën dhe shembullin në libër me rezultatet e nxënësve në lëndë të ndryshme, paraqesim grafikun duke bërë përzgjedhjen e mënyrës së grafikut që ne duam. Lexohet rubrika në libër: “Aktivitet”, e cila flet për paraqitjen grafike të të dhënave. Nga mësuesi/ja tregohet mënyra e futjes së grafikut në një dokument duke përdorur komandat e duhura, si dhe elementet përbërëse të grafikut duke përcaktuar emërtimin e tij, emërtimin e boshtit horizontal dhe emërtimin e boshtit vertikal.	

	<p>Po kështu tregohet edhe mënyra e përfshirjes së grafikut nga një faqe në <i>Excel</i> në një dokument <i>word</i>.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive të marra duke përdorur rubrikën: Provo veten</p> <p>Hapi III Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Mësuesi/ja i ndihmon në lidhje me hapat që ndiqen për zgjidhjen e problemeve. Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office, Microsoft Excel</i> etj.</p> <p>Koncepte kyçe: Ms Excel, Insert, Change chart Type, Column, Desing, Layout, Format etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit: Nxënësi zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimit, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e paraqitjes së të dhënave të një tabele në një grafik.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Paraqisni në një grafik të dhënat e një tabele të përdorur në një lëndë të caktuar, p.sh. të Gjeografisë, ku paraqiten vlerat e lartësisë së maleve të Shqipërisë.</i></p>	



Mësimi 2.6

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Shikimi paraprak i dokumentit te printuar (Print Preview) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: Përzgjedh opsionin <i>Print Preview</i> përpara se ta printojë dokumentin, për të parë cilësinë e printimit. Arrin të fshehë pjesët e tekstit ose të grafikut në një dokument, që të mos printohen.		<p>Situatat e te vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për realizimin e temës, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë...</p> <p>Si do të vepronit për të printuar një dokument pasi e keni përfunduar atë?</p> <p>Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit përgjigjen duke përdorur njohuritë që kanë marrë lidhur me përgatitjen e një dokumenti në programin <i>Word</i>. Nga mësuesi/ja demonstrohen me anë të videoprojektorit në laboratorin e Informatikës hapat që do të kenë parasysh nxënësit gjatë punës së tyre. Shkruhet një tekst në <i>Word</i> dhe më pas jepen udhëzimet që duhet të ndjekin nxënësit për të parë dokumentin përpara printimit. Mësuesi/ja duhet t'u bëjë të ditur nxënësve se sa herë që do të bëjnë ndryshime në dokument, duhet ta shohim përsëri atë në <i>Print Preview</i> përpara se ta printojnë, duke klikuar në <i>Office/Print</i> dhe më pas në <i>Print Preview</i>.</p> <p>Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit</p> <p>-Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë mbi problemet që hasen në shkrimin e një dokumenti zyrtar ose shkrimin e një teksti të caktuar.</p> <p>Mësuesi/ja tregon me anë të videoprojektorit disa nga funksionet e <i>Print Preview</i>. Çështje tjetër për diskutim me nxënësit mund të jetë dhe ajo që lidhet me mënyrat e fshehjes së një teksti që nuk duam të printohet. Lexohen në libër hapat që duhen ndjekur nëpërmjet komandave, duke provuar të dyja rastet: teksti bëhet i dukshëm në dokumentin e printuar; teksti fshihet që të mos printohet. Shpjegohen hapat përkatës: 1. klikojmë <i>Office/Print/word Options</i>; 2. në dritaren <i>Word Options</i> klikojmë rubrikën <i>Display</i>; 3. klikojmë <i>Hidden Text</i> dhe në fund OK</p>	

	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Plotësohen nga nxënësit të dyja rubrikat, pasi t’i kenë të qarta shpjegimet e situatave të dhëna më lart. Lexohet rubrika “Aktivitet”, e cila flet për paraqitjen grafike të të dhënave.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikën: Provo veten</p> <p>Hapi III : Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna gjatë mësimit. Ndahen në dy grupe: Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtar i tjetër i grupit. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre dhe ruajnë punën e secilit grup në një folder të veçantë, në kompjuterat e laboratorit të Informatikës.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office, Microsoft Word</i>.</p> <p>Koncepte kyçe: <i>Print, Print Preview</i> etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Lidhet me fushën e gjuhës dhe komunikimit: Nxënësi zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimit, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t’u përgjigjen pyetjeve konkrete për disa nga mënyrat e përdorimit të shikimit paraprak të dokumentit përpara se të printohet.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër. Detyrë shtëpie: Ndahet klasa në dy grupe. Grupi I do të bëjë ushtrimin 2 në faqen 28. Grupit II i caktohet ushtrimi 3 në faqen 28. Mësuesi/ja jep udhëzimet përkatëse për realizimin e detyrës.</p>	



Mësimi 2.7

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Printimi i dokumenteve Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh opsionet: printim me ngjyra, printim bardhezi, formatin e fletës; - përdor opsionin e printimit të fletës në të dyja anët e saj; - punon me kujdes që gjatë printimit të përdorë me kursim fletët dhe bojën. 		Situata e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... Përpara se të printojmë duhen pasur parasysh disa rregulla, që na sigurojnë një cilësi sa më të mirë të printimit dhe një paraqitje estetike të dokumentit që kemi përgatitur. Përveç kësaj, këto rregulla janë efikase pasi na ofrojnë mundësi kursimi të letrës ose të bojës së printerit kur na duhet të printojmë një numër të madh fletësh.	
		Situata e të nxënës (Veprime në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit gjatë diskutimit në klasë japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë për faqen e punës kur ata punojnë në <i>Word</i> , në <i>Excel</i> ose në <i>PowerPoint</i> . Nga mësuesi/ja demonstrohen me anë të videoprojektorit në laboratorin e Informatikës hapat përkatës të temës së mësimi. Më pas nxënësit punojnë individualisht për të provuar komandat e mësuara më lart.	
		Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë, si dhe duke u orientuar nga ajo çka tregohet në videoprojektor.	
		Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Diskutohet rreth rubrikës “Aktivitet dhe mënyrave që ofrojnë rubrikat përkatëse për printimin e një materiali të përgatitur.	
		Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Te rubrika “Provo veten” nxënësit kontrollojnë njohuritë e përvetësuara gjatë kësaj ore mësimore.	
		Hapi IV: Në drejtimin e mësuesit/es, nxënësit printojnë nga një dokument në forma dhe formate të ndryshme duke përdorur opsionet që mundëson printeri.	

<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office, Microsoft Word</i> etj.</p> <p>Koncepte kyçe: <i>printim, Add page, Odd page, Even pages</i> etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e përdorimit të printimit të dokumenteve të ndryshme.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Printoni një dokument që keni përgatitur si detyrë në një lëndë të caktuar gjatë javës.</i></p>	



Mësimi 2.8

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 2. Përpunimi digjital i tekstit Tema mësimore: Problemet gjatë printimit Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon aftësitë e fituara në temat e mëparshme; - ushtrohet në aktivitetin praktik dhe në punën në grupe. 		Situata e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për realizimin e kësaj teme, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Nëse ju duhet të printoni një tekst (jo më shumë se një faqe A4), i cili të përmbajë edhe tabela, shifra, fotografi nga pushimet ose nga aktivitetet e zhvilluara në shkollë ose në klasë, si do të vepronit? Po në rast se gjatë procesit të printimit lind ndonjë problem, si do ta zgjidhni?</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë përkatëse që kanë marrë në mësimet e mëparshme. Duke punuar në grupe të vogla në kompjuter, bashkë me nxënësit shqyrtojmë disa nga problemet që mund t'i identifikojmë: a) nëse printimi nuk kryhet, problemi mund të jetë te kabllot lidhëse ose te printeri; b) për të provuar nëse problemin e ka printeri, printojmë <i>Test page</i> duke ndjekur hapat e mëposhtëm: 1. ndjekim hapat <i>Start/Control Panel/Devices and Printers</i> dhe me të djathtën e mausit klikojmë ikonën <i>Printer</i> ; 2. zgjedhim <i>Printer Properties</i> dhe shtypim butonin <i>Print Test Page</i> . Kur ndodh bllokimi i letrës në printer, veprojmë në këtë mënyrë: 1. fikim printerin; 2. hapim kapakun e printerit; 3. heqim me kujdes letrën e ngecur në printer, duke e pastruar printerin; 4. mbyllem kapakun e printerit dhe e ndezim përsëri atë. Sigurohemi që drita e <i>Paper Out</i> -it nuk ndizet dhe fiket dhe që drita e <i>Pause-s</i> është e fikur. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit	

	<p>-Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë marrë dhe mënyrën e vendosjes së bojës në printer (video-shpjegim për lexuesin në CD).</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit U kujtohet nxënësve që përpara se të pastrohet printeri nga bllokimi i letrës, duhet të sigurohen që ai të jetë i fikur. Në të kundërt, printeri mund të dëmtohet.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur Ide për punë praktike Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikën “Ide për punë praktike”</p> <p>Hapi IV: Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër.</p>
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, paketa <i>Office</i> etj.</p> <p>Koncepte kyçe: printim, Add Page, Odd Page, Even pages , Control; Panel devices and printer, Test page.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi: Nxënësi zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund të përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e identifikimit të problemeve që hasen gjatë printimit.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Ushtroni në printimin e dokumenteve të ndryshme.</i></p>	

Mësimi 3.1

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 3. Kërkimi në Internet Tema mësimore: Kërkimi në internet Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor programet e <i>e-mail-it</i>; - menaxhon adresat elektronike të kontakteve në <i>e-mail</i>. 		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për realizimin e kësaj teme, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Rikujtojmë së bashku çfarë është e-mail-i?</i> <i>Adresa e e-mail-it, ashtu si adresa e shtëpisë duhet të jetë unike. Por, ndryshe nga adresa e shtëpisë, adresa e e-mail-it nuk identifikon vendin ku jeton përdoruesi. Ky është një opsion që të ofron bota virtuale...</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë që kanë për hapjen e një adrese e-mail-i, si dhe për shërbimet përkatëse që ofron ai. Mësuesi/ja i njeh nxënësit me programe të tilla si: <i>Gmail, Yahoo, Outlook, Outlook Express</i> etj. Gjithashtu, u shpjegohen në vija të përgjithshme mënyrat për gjetjen e kontakteve në Outlook, duke udhëzuar hapat e mëposhtëm. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit -Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë që kanë, si dhe duke iu referuar dosjes 3, mësimi I (video-shpjegim për lexuesin në CD). Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Mësuesja u kujton nxënësve se pikësëpari kompjuteri duhet të jetë i lidhur me Internetin, ndryshe puna nuk mund të realizohet. Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Ide për punë praktike Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikën: Provo veten	

	Hapi IV: Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër.
Burimet: Teksti mësimor, laborator i Informatikës, Internet, programet: <i>Gmail, Yahoo, Outlook, Outlook Express</i> etj. Koncepte kyçe: Mail, Inbox, People etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.	
 Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e hapjes së një adrese <i>e-mail</i> -i, si dhe përdorimin e saj për dërgimin dhe leximin e <i>e-mail</i> -eve.	
	<p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Nxënësit tregojnë rreth vështirësive apo problemeve që mund të kenë hasur gjatë ruajtjes së një prezantimi në skedarët e kompjuterit të tyre në shtëpi ose në laboratorin e Informatikës.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikat në libër. Hapi III: Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. - Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten. Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: <i>Nxënësi /ja</i> njeh mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të prezantimit të tij përpara një audience të gjerë, duke lidhur paraprakisht laptopin me videoprojektorin.</p>	
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti etj.</p> <p>Koncepte kyçe: ruajtja e prezantimit në programin <i>PowerPoint</i>.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t’u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e ruajtjes së një prezantimi.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: ndahet klasa në dy grupe dhe punojnë rreth ruajtjes së një prezantimi që kanë bërë në orët e mëparshme.</i></p>	



Mësimi 5.3

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Mënyrat e shfaqjes së slajdeve Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>-prezanton nga kompjuteri, duke i shfaqur slajdet me anë të videoprojektorit;</i> <i>-shfaq prezantimin duke përdorur animacione të ndryshme sipas llojit të PowerPoint-it ku ka punuar.</i></p>		<p>Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë...</p> <p><i>A keni ndonjë ide se cilat mund të jenë opsionet e shfaqjes së slajdeve në një prezantim?</i></p> <p>Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit përgjigjen duke përdorur njohuritë që kanë marrë për faqen e punës kur ata punojnë në PowerPoint. Mësuesi/ja shpjegon me anë të videoprojektorit temën e mësimi duke përdorur Slide Show (mësimi zhvillohet në laboratorin e Informatikës). Hidhet për diskutim çështja e treguar në libër nëpërmjet rubrikës: Aktivitet.</p>  <p>Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Mësuesi/ja diskuton me nxënësit: <i>- Tashmë, ju e dini se çfarë janë slajdet (slide-t) e prezantimit dhe përse shërbejnë ato. Cilat mund të jenë mënyrat e shfaqjes së slajdeve gjatë prezantimit nga kompjuteri?</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Zgjedhja e opsioneve të shfaqjes së slajdeve. Lexohet mësimi në libër. Tregohet mënyra për të përdorur <i>Slide Show</i> në dokumentin në <i>PowerPoint</i> me anë të komandave të duhura.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur</p>	

	<p>Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikat në libër. Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Tregojnë hapat që duhen ndjekur për shfaqjen e slajdeve. - Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten. Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit. Të gjithë nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore : <i>Nxënësi /ja</i> njeh mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të prezantimit të tij përpara një audience të gjerë, duke lidhur paraprakisht laptopin me videoprojektorin.</p>	
<p>Burimet: Teksti mësimor, Interneti etj. Koncepte kyçe : PowerPoint, Presentation, Picture, Movie, Sound, Notes Page.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete gjatë orës së mësimi dhe janë aktivë në pjesën më të madhe të kohës.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: ndahet klasa në tri grupe, ku secili do të përgatitë nga një prezantim me temat e mëposhtme:</i> -Dita e Tokës - Të mbrojmë mjedisin - Të kujdesemi për personat me aftësi të kufizuara</p>	



Mësimi 5.4

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Përshtatja e prezantimit për printim Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>-shton shënime në prezantimin e tij/saj;</i> <i>-përshtat slajdet për printim.</i>		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... Në një prezantim të përgatitur në mësimet e mëparshme, më duhet të shtoj disa shënime për të më orientuar gjatë paraqitjes së tij, por si të veproj? Në rubrikën View klikoj mbi komandën Notes Page view . Aty do të gjej një hapësirë ku mund të shtoj shënime. Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë mësuar. Note Page view quhet ndryshe “shënimet e folësit”. Për të shtuar shënime në një prezantim ndjekim këta hapa: <ol style="list-style-type: none"> 1. klikojmë në rubrikën View; 2. në grupin Presentation Vieës zgjedhim Notes Page; 3. shtojmë shënimet tona në dritaren e hapur “Click to add text”, poshtë slajdit. Hidhet për diskutim çështja e treguar në libër nëpërmjet rubrikës: Aktivitet	
			
		Mësimi shpjegohet me anë të videoprojektorit.	
		Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Përshtatja e slajdeve për printim Mësuesi/ja tregon hapat që ndiqen për të përgatitur një prezantim për printim: <ol style="list-style-type: none"> 1. hapim prezantimin në Ms PowerPoint; 2. në menyne Design klikojmë butonin Page Setup për t’i përshtatur slajdet për printim; <ol style="list-style-type: none"> 3. në dritaren dialoguese Page Setup të rubrikës 	

	<p>Slides sized for (përmasat e slajdeve), zgjedhim formatin e letrës që do të printohet (zakonisht A4);</p> <p>4. klikojmë Slide Orientation dhe zgjedhim njërin nga opsionet: Portrait (slajd vertikal) ose Landscape (slajd horizontal);</p> <p>5. në rubrikën Notes, handouts & outline zgjedhim orientimin (vertikal ose horizontal) e shënimeve të folësit.</p> <p>6. Klikojmë butonin OK.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Lexohet materiali në libër për mënyrën se si duhet të veprojmë për të printuar një prezantim duke përdorur komandat e duhura.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikën në fund të mësimit Provo Vetën Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Ndahen në dy grupe: Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1. Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore Nxënësi /ja njeh mënyrat kryesore për të përshtatur materialin për printim nga programi PowerPoint.</p>	
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti etj.</p> <p>Koncepte kyçe : <i>Ms PowerPoint, Note Page view etj.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimit, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit dinë si ta përgatitin një prezantim për printim.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur Në fund të orës, nxënësit zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër. Detyrë shtëpie: Printoni sipas grupeve të punës një prezantim.</p>	



Mësimi 5.5

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Printimi i prezantimit Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>-printon prezantimin e tij/saj;</i> <i>-printon disa slajde në një fletë të vetme.</i>		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për realizimin e kësaj teme, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Deri tani kemi mësuar si të printojmë një dokument në Word, gjithashtu mësuam se si të përshtatim slajdet e një prezantimi për printim.</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë, tregohen edhe një herë hapat që duhet të ndjekim për të printuar: 1. hapim prezantimin; 2. shtypim butonin Office/ Print ose Ctrl+P ; 3. në rubrikën Print Range të dritares dialoguese Print , zgjedhim një nga opsionet e mëposhtme: a) klikojmë opsionin All , kur duam ta printojmë të gjithë prezantimin; b) zgjedhim Current Slide , për të printuar pjesën e prezantimit në slajdin ku jemi; c) klikojmë Selection , kur duam të printojmë vetëm pjesën e selektuar të prezantimit; d) klikojmë Slides , për t'i printuar slajdet sipas renditjes numerike që duam; 4. në rubrikën Copies , klikojmë te Number of copies , për të përcaktuar numrin e kopjeve që do të printohen. 5. në rubrikën Handouts mund të zgjedhim: a) Slides per page , për të përcaktuar numrin e slajdeve që do të ketë një faqe e printuar; b) Order , për t'i printuar slajdet sipas një renditjeje horizontale ose vertikale; 6. rubrika Preview na mundëson një pamje paraprake të prezantimit përpara printimit; 7. pasi kemi zgjedhur të gjitha opsionet e duhura, klikojmë butonin OK ; 8. për mbylljen e prezantimit shtypim butonin Close . Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit	

	<p>Nxënësit tregojnë në videoprojektor projektin, i cili bëhet gati për printim.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit</p> <p>Lexohet në libër rubrika “Aktivitet” dhe demonstrohen nga disa nxënës hapat që ndoqëm për printim; tregohet dhe një tabelë, e cila tregon për mënyrat e kombinimit të tasteve për komandat përkatëse.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive duke përdorur rubrikat në libër.</p> <p>Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna. Ndiquen hapat e mëposhtëm për të përvetësuar më mire mësimin.</p> <p>Ndahet klasa në dy grupe.</p> <p>Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten</p> <p>Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1.</p> <p>Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtar i tjetër i grupit.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore :</p> <p><i>Nxënësi /ja njeh mënyrat kryesore të printimit të një dokumenti në një prezantim të Ms PowerPoint.</i></p>	
<p>Burimet:</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti.</p> <p>Koncepte kyçe: <i>Ms PowerPoint, Note Page view, Print Preview etj.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t’u përgjigjen pyetjeve konkrete për të realizuar printimin e një materiali.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i></p> <p>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 1, pika 4, për një projekt në një lëndë të klasës së shtatë.</p>	

Mësimi 5.6

Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Lidhja e laptopit me videoprojektorin Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: -përdor videoprojektorin; -konfiguron laptopin me videoprojektorin (nëpërmjet Ctrl+ F5 ose Ctrl + F8); -përshtat përmasat e monitorit të laptopit, nëse projektori kërkon përmasa specifike.		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Në mësimet e kaluara, ne e kemi zhvilluar temën edhe anë të videoprojektorit. Sot do të trajtojmë më hollësisht njohuritë e marra për videoprojektorin dhe për konfigurimin e tij me laptopin.</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Mësimi zhvillohet në trajtën e një aktiviteti praktik, në laboratorin e Informatikës. Të gjithë nxënësit duhet të kenë USB-në e tyre, ku kanë të ruajtura prezantimet që kanë përgatitur më parë në programin PowerPoint. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke përdorur njohuritë që kanë marrë. Ngrihet diskutimi: Si mund të bëhet lidhja e videoprojektorit me laptopin? Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Hapeni prezantimin tuaj në monitorin e laptopit (kompjuterit). Me ndihmën e mësuesit/es, lidhni videoprojektorin me laptopin dhe prezantojeni punimin tuaj para klasës. Lexohet materiali në libër  Kujdes! <i>Gjatë lidhjes së laptopit me videoprojektorin duhet të zbatoni rregullat e sigurimit teknik.</i> Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur	

	<p>Kontrolli i njohurive duke përdorur punën në grup. Realizohet bashkë me nxënësit lidhja e laptopit me videoprojektorin.</p> <p>Në përfundim të këtij aktiviteti praktik, diskutohet në klasë me nxënësit rreth problemeve që mund të kenë dalë gjatë paraqitjes së prezantimit me videoprojektor. Gjatë punës në laborator nxënësit duhet të mbajnë shënim problemet e hasura ose të rejtat që mësuan, me qëllim që në fund të orës të dorëzojnë një raport rreth temës që zhvilluan.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p><i>Nxënësi /ja njih mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të prezantimit të tij përpara një audience “të gjerë”, duke lidhur paraprakisht laptopin me videoprojektorin.</i></p>	
<p>Burimet:</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti etj.</p> <p>Koncepte kyçe : <i>Source, Ctrl+, Ctrl-, Ctrl0, Win+P, Screen resolution etj.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t’u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e lidhjes së laptopit me videoprojektorin.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i></p> <p>Detyrë shtëpie: <i>Praktikohuni në përdorimin e mënyrave të lidhjes së laptopit me videoprojektorin. Shënoni problemet që mund të hasni gjatë punës suaj.</i></p>	

Mësimi 5.7

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Njohja me programin Prezi Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave Nxënësi/ja: <i>-njeh mënyrën për hapjen e një llogarie në Prezi;</i> <i>-njeh ikonat bazë të Prezi-t për të bërë prezantime të ndryshme;</i> <i>-njeh ikonat bazë të Prezi-t për të bërë prezantime.</i>		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... Aktivitet <i>Le të shohim në videoprojektor një nga prezantimet e përgatitura prej jush, p.sh., atë me temë: “Të mbrojmë mjedisin”. Tashmë, ju i njihni shumë mirë shërbimet që ofron programi PowerPoint, por, si mendoni, a mund ta bëjmë edhe më interesant këtë prezantim duke përdorur animacione të ndryshme?</i> Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë për shërbimet që ofron programi PowerPoint, ndërsa mësuesi/ja u shpjegon atyre në lidhje me një program të ri, i cili ofron përdorimin e animacioneve të ndryshme në një prezantim. Ai/ajo thekson rëndësinë e këtij programi: <i>Prezi është një program, i cili na ndihmon të realizojmë prezantime me më shumë animacione sesa ato që përmban PowerPoint-i. E veçanta e Prezi-t është se ofron mundësinë e përdorimit të animacioneve të lëvizshme. Dy janë mënyrat për të përfutur nga shërbimet e programit Prezi:</i> 1. Nëse zgjedhim të punojmë <i>online</i> në programin Prezi, shërbimet e tij janë pa pagesë. 2. Në rast se duam që aplikacionin Prezi ta kemi në laptopin apo kompjuterin tone për të realizuar në çdo kohë prezantime të ndryshme, duhet ta blejmë atë. Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit <i>-Nxënësit diskutojnë bashkë me mësuesin/en për njohuritë që kanë marrë deri tani dhe për programin Prezi.</i>	

Nga mësuesi/ja prezantohet me anë të videoprojektorit një material i punuar në programin *Prezi*.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto **Kategorizimi i problemit**

Nga *link*-et e shfaqura zgjedhim <https://prezi.com/>,

Klikojmë **Log In**, pastaj **Sign Up**, në mënyrë që të krijojmë një llogari tonën për të punuar në **Prezi**

Online.

GET STARTED

Të dhënat që duhet të plotësojmë për hapjen e llogarisë në Prezi:

Emër:

Mbiemër:

Fjalëkalim:

Një nga pasionet që kemi:



i shkollimit:

Kujdes

Me këtë opsion të zgjedhur për hapjen e llogarisë në Prezi, prezantimet e realizuara bëhen publike dhe gjithkush mund t'i shohë.

Nuk duhet të harrojmë gjithashtu se për të punuar në këtë program, kompjuteri duhet të jetë i lidhur gjatë gjithë kohës me Internetin.

Tregohen hapat nëpërmjet videoprojektorit.

Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur

Kontrolli i njohurive duke u ushtruar për krijimin e një prezantimi me template të gatshëm.



Nxënësit plotësojnë në dyshe rubrikën e dhënë në libër. Ndahet klasa në dy grupe.

Create a new prez

Grupi I plotëson në dyshe pyetjen **1**.

Grupi II plotëson në dyshe pyetjen **2**.



Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit.

Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore: Nxënësi /ja njeh mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të prezantimit të tij përpara një audience të gjerë, duke lidhur paraprakisht laptopin me videoprojektorin dhe duke krijuar një prezantim.	
Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti. Koncepte kyçe : Programi <i>Prezi</i> .	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.	
 Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e përdorimit të programit <i>Prezi</i> dhe si realizohet hapja e një llogarie të re.	
 Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit do të zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: Ndahet klasa në grupe, ushtrimi 1 në libër.</i> Hyni në llogarinë tuaj në <i>Prezi</i> dhe zgjidhni një nga <i>template</i>-t që i përshtatet më shumë temës së prezantimit që do të realizoni në vijim.	

Mësimi 5.8



Fusha: TEKNOLOGJI/ TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Përpunimi i informacionit në <i>Prezi</i> Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave Nxënësi/ja: - shton informacione në slajdet e krijuara në <i>Prezi</i> .		Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë... <i>Tashmë ju keni mësuar se si të hapni një llogari në <i>Prezi</i> dhe jeni njohur me mënyrat e zgjedhjes së një <i>template</i>-i të gatshëm për të punuar në këtë program. Por, përveç këtyre, është e rëndësishme të njiheni edhe me format e përpunimit të informacionit në <i>Prezi</i>.</i>	

	<p>Situata e të nxënit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p><i>Nxënësit punojnë në grupe mbi prezantimet që kanë krijuar në programin Prezi gjatë mësimit të mëparshëm. Hyjnë në llogarinë personale në këtë program dhe hapin prezantimin e tyre.</i></p> <p><i>Diskutojnë me njëri-tjetrin rreth template-it të gatshëm që zgjedhën për krijimin e prezantimit. Me ndihmën e mësuesit/es, përpunohet informacioni që përmban Materiali (ora e mësimit zhvillohet në laboratorin e Informatikës).</i></p> <p>Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit</p> <p>Tregohen me anë të videoprojektorit hapat përkatës që duhet të ndjekin nxënësit gjatë punës së tyre.</p> <p>Nëse duan të shtojnë informacion mbi prezantimin e krijuar në programin <i>Prezi</i>, mjafton të klikojnë Slide 2. Më pas zgjedhin opsionet përkatëse.</p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit</p> <p>Nëse duan të shkruajnë tekst në prezantimin e tyre, mjafton të klikojmë Click to add text. Në këtë mënyrë mund të veprojnë me të gjithë rrathët e që shfaqen. Lexohet në libër rubrika “Aktivitet”.</p> <p>Mësuesi/ja tregon për mënyrat e ndryshimit të formës apo të figurave në prezantim duke përdorur komandat e duhura. Për ruajtjen e dokumentit të realizuar në <i>Prezi</i> klikohet Exit.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/praktikë e pavarur</p> <p>Kontrolli i njohurive duke u bazuar në një përmbledhje të shkurtër për mënyrën e ruajtjes së prezantimit në programin Prezi. Këtë e ilustron opsionet e mëposhtme:</p>
--	---

	<p>-<i>Edit</i> - nëse do të bëni ndryshime në prezantim.</p> <p>-<i>Present remotely</i> - nëse doni ta shihni edhe një here prezantimin.</p> <p>- <i>Doenload</i> - nëse doni ta shkarkoni prezantimin.</p> <p>- <i>Save a copy</i> - nëse doni të ruani një kopje të prezantimit.</p> <p>- <i>Share</i> - nëse do ta shpërndani atë te persona të tjerë.</p> <p>Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër.</p> <p>- Ndahet klasa në dy grupe.</p> <p>Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten.</p> <p>Grupi I plotëson në dyshe pyetjen 1.</p> <p>Grupi II plotëson në dyshe pyetjen 2.</p> <p>Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimi, pyetet anëtari tjetër i grupit.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</p> <p><i>Nxënësi /ja</i> njeh mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të prezantimit të tij në programin <i>Prezi</i> me anë të ndryshimeve që i bëhen një dokumenti në <i>Prezi</i>.</p>	
<p>Burimet:</p> <p>Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, të dhëna nga Interneti.</p> <p>Koncepte kyçe:</p> <p>Programi <i>Prezi</i> etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve konkrete për të treguar cilat janë disa nga mënyrat e përpunimit të informacionit në programin <i>Prezi</i>.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p><i>Detyrë shtëpie:</i> Ndahet klasa në dy grupe, ku secili grup përgatitet për të realizuar një prezantim të thjeshtë në <i>Prezi</i>, me temë nga ndonjë prej këtyre lëndëve: Gjeografi, Histori, Fizikë, Matematikë, Gjuhë Shqipe, duke zgjedhur një <i>template</i> të gatshëm.</p>	

Mësimi 5.9

Fusha: TEKNOLOGJI/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>Tematika 5: Prezantimi digjital Tema mësimore: Realizimi i prezantimit në Prezi Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave Nxënësi/ja:</p> <p>-realizon vetë një prezantim të thjeshtë në <i>Prezi</i>; -prezanton vetë <i>prezantimin e krijuar</i>.</p>		<p>Situatat e të vepruarit Bashkëbisedim, punë në grupe Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja hedh për diskutim si më poshtë...</p> <p><i>Tashmë e dini që përpara ruajtjes së prezantimit mund të zgjidhni një nga opsionet që ofrohen në programin Prezi. Le ti rikujtojmë së bashku:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Edit</i> - nëse do të bëni ndryshime në prezantim. - <i>Present remotely</i> - nëse doni ta shihni edhe një herë prezantimin. - <i>Download</i> - nëse doni ta shkarkoni prezantimin. - <i>Save a copy</i> - nëse doni të ruani një kopje të prezantimit. - <i>Share</i> - nëse do ta shpërndani atë te persona të tjerë. <p>Nxënësit në këtë mësim do të aftësohen të realizojnë vetë një prezantim në programin <i>Prezi</i>, duke përfshirë në të <i>template</i> të ndryshme</p> <p>Situata e të nxënësit (Veprimet në situatë) Përshkrimi kontekstual i situatës Hedh për diskutim çështjet e mësipërme: Nxënësit japin përgjigje duke përdorur njohuritë që kanë për të realizuar një prezantim në <i>Prezi</i>, duke zgjedhur një <i>template</i> të bardhë (sfond i bardhë).</p> <p>Klikojnë te Layouts që shfaqet në të djathtë të ekranit, ku zgjedhin slajdin duke klikuar mbi atë që duan të shfaqet në prezantimin e tyre.</p> <p>Hapi I –Rrjeti i diskutimit Identifikimi i problemit</p> <p>Diskutohet rreth rubrikës: Aktivitet.</p> <p><i>Nga punimet që keni realizuar në programin PowerPoint, zgjidhni një prezantim që të përmbajë 5-6 slajde. Shtojini këto slajde në prezantimin që keni krijuar në Prezi, duke</i></p>	

	<p><i>ndjekur ndërkohë shpjegimin apo hapat përkatës në CD-në tuaj.</i> <i>Mësuesi tregon me anë të videoprojektorit fotot që ilustrojnë aktivitetin e mësipërm.</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Kategorizimi i problemit Lexohet nga nxënësit rubrika “Aktivitet”. Mësuesi/ ja shpjegon mënyrat konkrete për kalimin e slajdeve nga PowerPoint-i në prezantimin Prezi, duke përdorur komandat e duhura.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/ praktikë e pavarur Kontrolli i njohurive duke përdorur ushtrimet 1 dhe 2 në libër. Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në libër. Ndahet klasa në grupe. Nxënësit plotësojnë rubrikën: Provo veten. Nxënësit argumentojnë përgjigjet e dhëna, nëse njëri nuk e plotëson saktë argumentimin e tij, pyetet anëtari tjetër i grupit. Të gjithë nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: <i>Nxënësi /ja</i> njeh mënyrat kryesore të përpunimit të informacionit dhe të shfaqjes së një prezantimi në programin <i>Prezi</i>, si dhe kalon slajdet nga PowerPoint-i në prezantimin në <i>Prezi</i>.</p>	
<p>Burimet: Udhëzues për përdorimin e gjuhës së kompjuterit, njohuritë e nxënësve, informacione nga Interneti. Koncepte kyçe : <i>Ms Power Point, Prezi etj.</i></p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi. Nxënësi/ja zhvillon fjalorin dhe komunikimin me të tjerët gjatë përshkrimit të funksioneve të programeve dhe të gjuhës së kompjuterit. Prezantimet: në paketën <i>Office të Microsoft-it</i>.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; ndërtimin e njohurive të reja; prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.</p>	
<p> Vlerësimi: Situata quhet e realizuar kur nxënësit u përgjigjen pyetjeve konkrete në lidhje me realizimin e një prezantimi në programin <i>Prezi</i>.</p>	
<p> Detyrat dhe puna e pavarur <i>Në fund të orës, nxënësit zhvillojnë ushtrimet e dhëna në libër.</i> <i>Detyrë shtëpie: ndahet klasa në grupe, ku secili grup punon ushtrimin 3 në faqen 81.</i> Realizo një prezantim të thjeshtë me një template të gatshëm, duke shtuar disa slajde të marra nga një prezantim që ke realizuar në PowerPoint.</p>	

3 Vlerësimi

VLERËSIMI PERIODIK TREMUJOR DHE VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I NXËNËSIT

KLASA E SHTATË

Vlerësimi tremujor

Vlerësimi periodik tremujor përfshin:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar, të mbajtura për periudhën tremujore.*
 - *Vlerësimin me testim ose me detyrë përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.*
 - *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/es për periudhën tremujore.*
- Këto vlerësime shënohen në regjistër në kolonat përkatëse, në përfundim të çdo tremujori.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm të tri periudhave tremujore.*
 - *Notën vjetore të vlerësimit me testim ose me detyrë përmbledhëse të tri periudhave tremujore.*
 - *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es të tri periudhave tremujore.*
- Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me testim ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit/es	20%

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë si më poshtë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
- Përcaktohet nota vjetore e testimit ose e detyrës përmbledhëse (NVT).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/es (NVP).
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7).

$$(NVV \times 0.4) + (NVT \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota vjetore përfundimtare}$$

Shembull:

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Nota vjetore			Nota vjetore përfundimtare
NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	
8	9	10	9	10	10	8	10	10	8	10	10	9

$$(8 \times 0.4) + (10 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 9.2$$

Nota vjetore përfundimtare: 9.

Nota vjetore përfundimtare: 9.

Disa lloje vlerësimi që mund të përdoren nga mësuesit

a. Vlerësimi formues

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësuesi/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkuara. Për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm, pasi ata fillojnë të analizojnë në mënyrë të thelluar çfarë janë në gjendje të arrijnë dhe këtë ta përdorin si pikën e tyre të fortë. Gjatë këtij vlerësimi, mësuesi/ja duhet të vëzhgojë herë pas here nxënësit, të realizojë bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit

Një formë tjetër vlerësimi që e ndihmon nxënësin/en të shohë se si ai avancohet hap pas hapi, është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh të organizuara prej tij gjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi dhe produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënësi/ja të koleksionojë ato dokumente që atij/asaj mund t'i shërbejnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol nxënësi/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër. Nëpërmjet portofolit, mësuesi/ja vlerëson në mënyrë të vazhdueshme nxënësin/en. Gjithashtu, portofoli shërben si dokument ndihmës për mësuesin/en për të vlerësuar nxënësit në fund të tremujorit.

c. Vetëvlerësimi

Ky lloj vlerësimi është vetëgjykim i nxënësit/es për arritjet e tij/saj. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësuesi-i/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi

dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta e kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit/es i jepen kritere të sakta, mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj. *P.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit/es të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe, më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.*